



Pranuar / Dorezuar Primijsno / Primalo Received / Delivered	10 - 10	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SIPMSHKK 6053 / 2022			1/6	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A nr.755/2019

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari -kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi - anëtarë dhe Zyle Millaku-Gojnovci, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, sipas Aktgjykimit A.nr.189/2020 të datës 04.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative i pranuar me datë 09.09.2022, kanë rishqyrtuar ankesën me numër A02/748/2017 të datës 27.11.2017, të parashtruar nga ankuesi [redacted], me adresë fshati Tomoc Gurrakoc Istog, në çështjen juridike "kontestim konkursi" kundër organit të punësimit Ministria e Drejtësisë -Shërbimi Korrektues i Kosovës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.10.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e parashtruar ankesa me numër A.02/748/2017 të datës 27.11.2017, e parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Vendimi nr. 40KA i datës 13.11.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Drejtësisë - Shërbimi Korrektues i Kosovës në Prishtinë.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] kundër Vendimit me numër A02/748/2017 të datës 16.01.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka parashtruar kërkesëpadi me datë 02.02.2018 në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative, e cila me datë 15.11.2019 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër Anr.198/2018 të pranuar me datë 11.12.2019 në Këshill, me numër protokolli 5757/2019, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadin e ankuesit, duke anuluar Vendimin me numër A.02/748/2017 të datës 16.01.2018 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe çështjen e kthen në rishqyrtim dhe rivendosje tek Këshilli.

Me datë 17.01.2019 Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për mes njoftimit me numër protokoll 115/2019 e ka njoftuar ankuesin lidhur me rrethanat e krijuara në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se nuk ka pasur korum për të shqyrtuar dhe vendosur sipas Aktgjykimit me numër Anr.198/2018, duke e udhëzuar që të vazhdoj në gjykatën kompetente për konflikt administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative, me datë 04.07.2022 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër A.nr. 189/2020, të pranuar në Këshill me datë 09.09.2022 me numër protokoll 5256/2022, me të cilin Aktgjykim e ka anuluar Njoftimin e datës 17.01.2020 dhe ka detyruar të njëjtin që të vendos sipas Aktgjykimin me numër Anr.198/2018 të datës 11.12.2019.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Aktgjykimin me numër Anr.189/2020 të datës 09.09.2022 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative me nr. protokoll 5256/2022; Aktgjykimin me numër Anr.198/2018 i datës 15.11.2019 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Administrative i pranuar me date 11.12.2019; Ankesën me nr protokoll 6173/2017 e datës 27.11.2017 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi nr.40KA i datës 13.11.2017 i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Pergjigje në ankesë nga organi i punesimit e datës 08.12.2017 (faqe 1/177 bashke me shkresat e lëndës); Rekomandimi për emërimin e kandidatit të suksesshem i datës 06.10.2017; Autorizimi i MAP-it i datës 06.09.2017; Opinion i Departamentit të buxhetit i datës 03.08.2017; Kërkesë për fillimin e rekrutimit në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Renditja përfundimtare e kandidatëve të intervistuar të datës 06.10.2017; Raporti final i komisionit rekrutues; Përmbledhja e vlerësimeve individuale; Vlerësimet individuale të kandidatëve të testit me shkrim; Përmbledhja e vlerësimeve individuale të testit me shkrim të datës 03.10.2017 për pozitën "Zyrtar për trajtimin e të burgosurve dhe çështje sociale -Dubrave; Renditja përfundimtare e kandidatëve; Lista për intervist me gojë e datës 06.10.2017; Pyetjet e komisionit përzgjedhes për kandidatët në intervistën me gojë; Vendimi i komisionit përzgjedhes me nr.1354 të datës 26.09.2017; Kriteret e zgjedhjes së listës së ngushte me datë 27.09.2017; Procesverbali i datës 27.09.2017; Deklarate e datës 02.10.2017; Lista e kandidatëve për testin me shkrim të datës 02.10.2017; Lista përfundimtare e përzgjedhjes për listën e ngushtë e datës 27.09.2017; Regjistri i kërkesave të pranuar; Kriteret e zgjedhjes së ngushtë; kopjet e testit me shkrim të datës 03.10.2017; Aplikacioni me dosje i D. H i datës 13.09.2017; Aplikacioni me dosje i V. M i datës 18.09.2017; Aplikacioni me dosje i N. Sh i datës 14.09.2017; Aplikacioni me dosje i S. G i datës 19.09.2017, dhe Ankesa e parashtruar nga ankuesi me datën 25.11.2017 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Shërbimin Korrektues të Kosovës; Aktvendimin e datës 07.12.2018; Padin e datës 02.02.2018; Përgjigjen në padi e datës 14.01.2019; Fletëkthesën e datës 15.01.2019; Procesverbalin e datës 15.11.2019 nga seanca dëgjimore; Fletëkthesën e datës 19.01.2018; Fletëkthesën e datës 24.06.2022;E-maila(1-7 faqe);Njoftimn mbi vendimin nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës për Kolegjin "AAB Riinvest" i datës 13.07.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi i punësimit, ka konstatuar se ankesa e ankuesit Nysret Shatri, është e papabuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit Nysret Shatri, i cili pretendon se Komisioni Përzgjedhës me rastin e përzgjedhjes së kandidatës së suksesshme për vendin e punës "Zyrtar për Trajtimin e të Burgosurve dhe Çështjes Sociale-QK në Daubrav", në Shërbimin Korrektues të Kosovës, nuk ka vlerësuar drejtë përgaditjen profesionale dhe përvojën e punës sipas kriterëve të konkursit, si dhe pretendon se Vendimi i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin Nr.04/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se kriteret e shpalljes sipas konkursit për pozitën "Zyrtar për Trajtimin e të Burgosurve dhe Çështje Sociale-QK në Dubrav", në Shërbimin Korrektues të Kosovës, kanë qenë:

- Diplomë *Universitare - Fakulteti Filozofik, Filologjik, Juridik,*
- *Përvoja e punës së paku 2 vite*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se Ministria e Drejtësisë - Shërbimi Korrektues i Kosovës, me datë 08.09.2017 ka shpallur konkursin për vendin e lirë të punës "Zyrtar për Trajtimin e të Burgosurve dhe Çështjes Sociale-QK në Dubrav", pasi ka pranuar aprovimin e datës 06.09.2017 nga Ministria e Administratës Publike/DASHC, ndërsa me datë 26 .09.2017 është themeluar Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil prej pesë (5) anëtarëve, në pajtim me nenin 7 paragrafin 1 i Rregullorës Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil. Po ashtu Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, më datë 27.09.2017 ka përgatitur listën e shkurtër brenda afatit ligjor të përcaktuar në nenin 26 të Rregullorës Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: "*Përgatitja e listës së shkurtër zhvillohet brenda pesë (5) ditëve të punës pas afatit të fundit të përcaktuar në shpalljen e rekrutimit*".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil i Shërbimit Korrektues të Kosovës, poentimin e kandidatëve për listë të ngushtë e ka bërë në pajtim me nenin 28 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, në të cilën janë të përcaktuar kriteret për përfshirje në listën e ngushtë ku përcaktohet se: "*Anëtarët e KPSHC-së vlerësojnë aplikacionet në bazë të kriterëve në vijmë: 1.1 arsimimi dhe kualifikimi profesional; 1.2. përvoja e punës profesionale; 1.3. shkathtësitë dhe aftësitë; 1.4. elemente të tjera të meritës*",.... secili anëtar vlerëson kandidatin në secilin kriter. Numri maksimal i secilit kriter është 20 pikë. Numri maksimal është 80, ndërsa minimumi për vazhdimin e kandidatit në procedura të tjera është 40 pikë. Kandidatet, të cilët nuk arrijnë numrin minimal të pikëve përjashtohet nga fazat e tjera të përzgjedhjes", andaj në rastin konkret Kolegji konstaton se në listën e ngushtë është përfshirë ankuesi dhe kandidati i përzgjedhur.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës në Shërbimin Korrektues të Kosovës, testin me shkrim e ka përpiluar në pajtim me nenin 36 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 dhe nën paragrafin 1.3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, me datë 12.10.2017. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil, gjatë zhvillimit të procedurës së rekrutimit deri në përzgjedhjen përfundimtare, ka vepruar drejtë duke bërë vlerësimet e testit me shkrim dhe me gojë si për ankuesin, po ashtu edhe për kandidaten e

përzgjedhur duke vepruar në pajtim me dispozitat e nenit 37 dhe 39 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, dhe në bazë të vlerësimeve kandidatja e përzgjedhur ka arritë gjithsejtë 407 nga pikët e përgjithshme nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, ndërsa ankuesi ka arritur e gjithsejtë 342 pikë të përgjithshme nga testit me shkrim dhe intervistës me gojë.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, konstaton se përzgjedhja e kandidatës është bërë në pajtim edhe me dispozitat e nenit 40 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, i cili përcakton se: *"Në shërbimin civil emërohen kandidatët të cilët kanë arritur numrin më të madh total të pikëve në testimin me shkrim dhe me gojë", "Kandidat i suksesshëm konsiderohet ai, i cili në testin e përgjithshëm (testin me shkrim dhe me gojë) ka jo më pakë se 60% të maksimumit të pikëve të caktuara"*, në rastin konkret konkursi është shpallur për një (1) pozitë në Qendrën Korrektuese në Dubravë dhe ankuesi pas vlerësimit të testit me shkrim dhe me gojë ka arritë gjithsejtë 342 pikët e përgjithshme, dhe është renditur i dyti (2) në listën përfundimtare të kandidatëve.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke marrë për bazë vërejtjet e dhëna në Aktgjykimin me numër A.nr. 189/2020 të datës 15/11/2019 ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me përgatitjen profesionale të kandidatës së përzgjedhur në vendin e lirë të punës *"Zyrtar për Trajtimin e të Burgosurve dhe Çështjes Sociale-QK në Dubravë"*, në Shërbimin Korrektues të Kosovës, nuk janë të bazuara sepse znj. ka plotësuar kriteret e konkursit të shpallura me datë 08.09.2017, e cila posedon Diplomë me Nr.637/15 të Studimeve Themelore Universitare, të përfunduar me datës 27.06.2015 në Kolegjin AAB në Prishtinë, i cili institucion i arsimit është i akredituar në Agjencinë e Akreditimit të Kosovës përmes vendimit Nr.284/11 të datës 13/07/2011, fakt që është konfirmuar edhe përmes shkresës/e-mailit, të datës 01/04/2021 nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, ndërsa sipas po të njëjtës shkresë të potencuar më lartë nga Agjencia e Kosovës për Akreditim konfirmohet se *"në periudhën kur ka ndjekur studimet kandidatja e përzgjedhur në këtë institucion sipas organizimit të brendshëm, kolegji nuk ka qenë i ndarë në fakultete. Pra programi ka ekzistuar vetëm si program i studimit në kuadër të kolegjit, e nuk ka qenë pjesë e ndonjë njësie organizative si fakultet apo departament"* dhe se bazuar në këtë sqarim zyrtarë Kolegji konstaton se përgatitja profesionale është konformë kriterëve të konkursit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave konstaton se pretendimet e ankuesit lidhur me përvojën e punës pas diplomimit janë të pa qëndrueshme, sepse në bazë të provave që gjenden në shkresat e lëndës së kandidatës së përzgjedhur, është vërtetuar se kandidatja e përzgjedhur ka përvojë të punës mbi dy (2) vite si në vijim: nga data 15.01.2013 e deri me datë 30.06.2016 në pozitën, *"Punëtoare tregtare"* nw SH.P.K "Jafa" në Istog; nga data 08.08.2016 deri me datë 18.11.2016 në pozitën *"Zyrtare për punë sociale"* në Qendrën Korrektuese në Dubravë; nga data 01.12.2016 dhe ka vazhduar në pozitën *"Administratorë"* në *"OJQ"* ABA-K në Istog, dhe rrjedhimisht duke u bazuar nw dëshmitë e ofruara Kolegji konstaton se kandidatja e përzgjedhur nga data e diplomimit respektivisht nga data 27.06.2015 deri në ditën kur ka aplikuar me datë 20.09.2017, ka gjithsejtë dy (2) vite e dy (2) muaj përvojë pune pas diplomimit, që nënkupton se e njëjta/apo kandidatja e përzgjedhur e ka plotësuar kriterin e përvojës së punës të përcaktuara sipas konkursit të datës 08.09.2017, të shpallur nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, për vendin e

punës "Zyrtar për Trajtimin e të Burgosurve dhe Çështje Sociale-QK në Dubrav" i cili kanë qenë: „Përvoja e punës së paku 2 vite” dhe mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i pabazuar.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha dëshmive për përgatitjen profesionale dhe përvojës së punës të bashkangjitura në dosjen e kandidatës së përzgjedhur dhe të ankuesit, ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës për Shërbimin Civil i Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka vlerësuar drejtë me rastin e përzgjedhjes përfundimtare të kandidatës së suksesshme për pozitën "Zyrtar për Trajtimin e të Burgosurve dhe Çështje Sociale-QK në Dubrav" në Shërbimi Korrektues i Kosovës, duke u bazuar në nenin 2 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku përcakton se: *"Merita-veçantia e cila krijon të drejtën e punësimit të një kandidati në një pozitë në shërbimin civil pas përfundimit të suksesshëm të procedurës konkurruese të përzgjedhjes*", sepse kandidatja e përzgjedhur i ka përmbushur kriteret e veçanta dhe të përgjithshme të kërkuara në konkursin e shpallur me datë 08.09.2017, për pozitën „ Zyrtar për Trajtimin e të Burgosurve dhe Çështje Sociale-QK në Dubrav” në Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit të gjitha provave të lëndës dhe bazuar edhe në vërejtjet e dhënë në Aktgjykim ka konstatuar se Komisioni Përzgjedhës i Shërbimit Civil në Shërbimin Korrektues të Kosovës, lidhur me zhvillimin e procedurës së rekrutimit për pozitën "Zyrtar për Trajtimin e të Burgosurve dhe Çështje Sociale-QK në Dubrave", që nga shpallja publike e konkursit më datën 08.09.2017 e deri në shpalljen për publikimin e rezultateve të procedurës së rekrutimit ka vepruar në pajtim me nenin 11 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton që: *„Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mos diskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë, në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve”* dhe nenin 18 paragrafin 1 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës i cili përcakton që: *„Pranimi në Shërbimin Civil mbështetet në parimet e meritës, me shpallje publike të pozitave të lira, me transparencë të procesit, me objektivitet dhe paanësinë e komisionit testues, mos diskriminimin e kandidatëve dhe të drejtën për t’u ankuar në fund të procedurës”*, si dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar që Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Ministrisë së Drejtësisë - Shërbimi Korrektues i Kosovës, me rastin e nxjerrjes së Vendimit nr. 40KA të datës 13.11.2017, ka vepruar në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën Administrative dhe Rregulloren Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe të Ankesave, sepse ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A nr.755/2019.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

MAJSCORE GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit, _____ ;
- Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamentit për Çështje Administrative ;
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK- së.